



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I PSIKOLOGUT
KËSHILLI KOMBËTAR



Tiranë më,13.07.2022

V E N D I M

Nr.17, datë 13.07.2022

Në mbështetje të ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenin 6.2.ç.), të këtij ligji,

VENDOSI:

1. Të specifikojë fushën e kompetencës për ushtrimin e profesionit të psikologut në fushën e drejtësisë me 8 (tetë) vota Pro 1 (një) Abstenim nga 9 anëtarë të Këshillit Kombëtar prezent në mbledhje, si më poshtë:
Të gjithë psikologët pjesë e regjistrimit elektronik të cilët janë me rekomandime nga grupi adhoc i verifikimit brenda datës 23 shtator të depozitojnë pranë Urdhrit dokumentacionin plotësues si më poshtë:
 - a. Vërtetim të rifreskuar të punës në të cilën ndodhen aktualisht
 - b. Vërtetime që provojnë ushtrimin e profesionit të psikologut në të kaluarën (nëse i disponojnë). Të gjitha këto vërtetime të pasqyrojnë kohën e plotë të punës si psikolog ndër vite
 - c. Të gjitha vërtetimet e mësipërme duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e pagesës së kontributeve shëndetësore e shoqërore për të gjithë kohëzgjatjen e punës Tuaj si psikolog.

2. Të gjithë psikologët pjesë e regjistrimit elektronik dhe ata që do të bëjnë në të ardhmen trajnimin e posaçëm në drejtësi duhet të sjellin një herë në vit pas thirrjes së Urdhrit
 - a.Vërtetim të rifreskuar të punës.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

PRESIDENTE E URDHRI

Dr. Valbona TRESKA

SEKRETARE

Armira BABOÇI

Bly. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, kati II, Ap.9, Tiranë, email:
sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035544 51 1804